



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 13.01.2026

MBLEDHJA Nr. 02,
Datë 15.01.2026, ora 13:15
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 15.01.2026, ora 13:15**, do të zhvillohet mbledhja nr. 02 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më date 08.01.2026.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin dhjetor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “INFO-telecom” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e aseteve të saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
9. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “VIVID POWER” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

10. Mbi disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 234, datë 05.11.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
11. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 02.12.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.
12. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.
13. Mbi përcaktimin e vlerës së detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës.
14. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI